

KQZ DHE STANDARDET E TRANSPARENCËS DHE TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

Raporti I

Mars 2021



Funded by
UK Government

Ky material është përgatitur me mbështetjen financiare të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Sidoqoftë, pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të qeverisë britanike.

KQZ DHE STANDARDET E TRANSPARENCËS DHE TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

Raporti I

Mars 2021



Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar KQZ dhe fushatën elektorale, si pjesë të angazhimit në projektin "Monitoring the 2021 Parliamentary Elections in Albania" mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes ambasadës britanike në Tiranë.

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

EKIPI REALIZUES

Ekipi i ekspertëve

Eno Mujo (Muja Law)
Dëshira Pasko

Kopertina

M&P Studio

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2021

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë



PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. HYRJE
 2. GJETJET KRYESORE
 - 2.1. REKOMANDIME
 3. VOTA E EMIGRANTËVE/VOTIMI NGA JASHTË VENDIT
 4. DEKRIMINALIZIMI
 5. COVID-19 DHE E DREJTA E VOTËS
 6. DOKUMENTACIONI PËR VOTUESIT
 7. PROBLEMATIKA ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME KQZ
 8. KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE (KAS) DHE VEPRIMTARIA E TIJ
-



1. HYRJE

Më datë 25.04.2021 Shqipëria do të zhvillojë zgjedhjet e saj të radhës parlamentare. Këtë vit, ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, vendi ynë përballet me disa rregulla të reja lidhur me mënyrën se si do të zhvillohen ato. Këto ndryshime, siç ndodh rëndom në Shqipëri, erdhën pa konsultime publike dhe përmes marrëveshjeve politike të iniciuara pas presioneve të shumta nga faktori ndërkombëtar. Pakti i Këshillit Politik u shpreh me një marrëveshje të dakordësuar më 5 qershor 2020, por në korrik mazhoranca inicioi ndryshime kushtetuese dhe më pas edhe ndryshime në Kodin Zgjedhor, duke sjellë ndryshime të reja në legjislacionin zgjedhor, në sistemin zgjedhor, në praktikën zgjedhore dhe në elementë të veçantë të administrimit zgjedhor.

Ndryshimet e "minutës së fundit" në përpjekje për të kapur limitet kohore ligjore, u shoqëruan jo vetëm me kontestime politike paraprake mbi bazën ligjore, por edhe me paqartësi, si dhe me nxitim për krijimin e strukturave të reja drejtuese të procesit zgjedhor. Në praktikën shqiptare kritikantët e përhershëm kanë qenë se partitë kanë vullnet minimal për respektimin e legjislacionit zgjedhor apo e lexojnë dispozitën ligjore në forma krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, traditë që vijon të shfaqet edhe tani.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar KQZ dhe fushatën elektorale, si pjesë të angazhimit në projektin "*Monitoring the 2021 Parliamentary Elections in Albania*" mbështetur financiarisht nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes ambasadës britanike në Tiranë. Pjesë e projektit është monitorimi aktiv i respektimit të bazës ligjore mbi zgjedhjet, monitorimi i detajuar i aktivitetit të KQZ dhe akteve të nxjerra prej tij, reagimi i publikut dhe aktorëve politikë ndaj vendimmarrjes, si dhe ngritja e një sistemi "alert" që sjell në vëmendje akte të munguara ligjore apo çështje më rëndësi për zgjedhjet, por që nuk janë ende axhendë institucionale. Stafi i ISP ka marrë pjesë në takime konsultative me KQZ dhe me shoqërinë civile që monitoron zgjedhjet, duke shprehur shqetësimet e veta të vazhdueshme, por edhe duke ofruar rekomandime konkrete për rrugëzgjidhje. Sistemi "alert" ia mundëson ISP një kontribut konstruktiv në drejtim të rritjes së transparencës dhe të standardeve të procesit zgjedhor.

Ky raport synon të hedhë dritë mbi disa aspekte lidhur me sa më sipër, duke u përpjekur gjithashtu të japë sugjerime mbi mënyrën se si mund të tejkalohen këto problematika të lindura rishtazi.



2. GJETJET KRYESORE

- **ISP vlerëson se kuadri ligjor mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 nuk u ndërtua mbi standardin e konsensusit dhe besimit reciprok midis mazhorancës dhe opozitës politike, sidomos pas ndryshimeve të njëanshme kushtetuese dhe reflektimi i tyre në Kodin Zgjedhor. Kjo dobësi e legjislacionit zgjedhor ka ndikimin e vet edhe në standardet e përgatitjes, organizimit dhe zhvillimit të procesit zgjedhor.**
- **KQZ nuk është më një strukturë e identifikuar e përgjegjësisë, por një organ kompleks, në tri nivele, secila të pavarura nga njëra-tjetra, dhe shpesh edhe me lexime të ndryshme të Kodit Zgjedhor. Rasti i vendimmarrjeve të ndryshme për të njëjtat fakte nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe struktura e KAS është një prej treguesve të diferencës në lexime të të njëjtave dispozitave ligjore.**
- **Fushata elektorale ka nisur de facto shumë më herët sesa periudha e parashikuar nga Kodi Zgjedhor. KQZ ka drejtuar apele publike, por një ndërhyrje më aktive e konkrete e tij do të kishte qenë shumë më efektive për t'i dhënë fund abuzimit me periudhën paraelektorale.**
- **Koha e shkurtër në dispozicion të implementimit të ndryshimeve të ndodhura së fundmi në legjislacionin zgjedhor ka bërë që të shfaqen problematika të shumta në këtë drejtim. Këto problematika lidhen kryesisht me vendimmarrje të diskutueshme të organeve të KQZ-së, si dhe me interpretimet e ndryshme të terminologjisë së përdorur në ligj dhe aktet nënligjore me qëllim zbatimin e Kodit Zgjedhor.**
- **Legjislacionit zgjedhor i mungon një manual shpjegimi i dispozitave, i pranuar nga të gjithë aktorët politikë dhe i qartë me frymën kushtetuese, Kodin Zgjedhor dhe praktikave mira zgjedhore.**
- **Partitë dhe koalicionet politike humbën rastin të përdorin të drejtën e tyre për të dërguar paraprakisht listat emërore për verifikim në kuadër të ligjit 138/2015 (dekriminalizimit).**
- **Strukturat e KQZ janë përpjekur të nxjerrin aktet nënligjore brenda afatit ligjor, por të dhënat monitoruese të ISP tregojnë se 18% e këtyre akteve nuk ishin miratuar ende megjithëse afatet ligjore ishin tejkaluar.**



- **Përbërja e deleguar politike në KAS dhe në Rregullator është reflektuar edhe në vendimmarrjet e tyre politike, duke i dëmtuar pritshmëritë dhe nevojat për integritet dhe standarde më të larta zgjedhore.**
- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi i vetëm që ka tentuar të jetë transparent dhe bashkëpunues me publikun, i hapur ndaj medias dhe shoqërisë civile, pranues dhe reflektues i raporteve kritike dhe rekomandimeve, në kontrast të thellë me dy strukturat e tjera të KQZ.**

2.1. REKOMANDIME KRYESORE NË STADIN AKTUAL

- **KQZ ka nevojë emergjente të bëjë standardizimin e legjislacionit zgjedhor dhe praktikave zgjedhore, në mënyrë që interpretimet e ndryshme të neneve të Kodit Zgjedhor të gjejnë zgjidhje përpara fushatës.**
- **Organet e KQZ, sidomos KAS dhe Rregullatori duhet të jenë më transparente, më të pavarura dhe më llogaridhënëse me publikun, duke sugjeruar organizim prej tyre të konferencave të shtypit për sqarimet e vendimmarrjes, si dhe miratimin e një manuali mbi konceptet e KAS rreth dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe të praktikës së mirë të vendeve të tjera në vendimmarrjet lidhur me shkeljet zgjedhore.**
- **Interpretime të KQZ, si rasti i burimeve shtetërore në fushatën elektorale apo i përcaktimit të limitit të kandidatëve për subjektet politike në zonat zgjedhore, krijojnë debat për qëndrime subjektive që mund të passjellin pasoja në elementë të ndryshëm të procesit zgjedhor. Leximi i Kodit me të njëjtën gjuhë dhe kodifikimi i rregullave do të kishte qenë një rrugëzgjidhje më oportune dhe më konstruktive. Fakti që pothuajse të gjitha subjektet dërguan në KQZ listë shumëemërore më të madhe sesa numri i parashikuar nga KQZ është më shumë pasojë e paqartësisë së dispozitës sesa përgjegjësi e tyre.**
- **Disa akte nënligjore të miratuara në organet e KQZ kanë nevojë për rishikim. Shoqëria civile ka adresuar rekomandime dhe disa raporte të tyre kanë identifikuar raste konkrete që kërkojnë përmirësime. Një reagim më konstruktiv i KQZ do të ishte i mirëpritur në raste të tilla.**
- **ISP vlerëson se do ishte me vend që të përcaktohej më qartë në nenin 10 ndarja e përgjegjësisë institucionale dhe asaj personale në rast të mosraportimit apo promovimit të veprimtarive të ndaluara nga zyrtarët e lartë. Gjithashtu çmojmë se nevojitet të përkufizohet më qartë, se cilët janë "*subjektet nën përgjegjësi administrative*", për të cilët parashikohen sanksionet në nenin 10, pika 1 të Vendimit Nr.9 të Komisionit Rregullator.**



- **Për garantimin e respektimit të ligjit Nr.138/2015, është e nevojshme të merren masat për koordinimin paraprakisht¹ të veprimeve ndërmjet institucioneve të ngarkuara me detyra sipas Kodit Zgjedhor dhe ligjit 138/2015, si dhe për angazhimin maksimal të KQZ për sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e përshtatshme² për përpunimin e të dhënave në formularët e vetëdeklarimit për rreth mijëra kandidatë, përpara datës së zgjedhjeve.**
- **Parashikimet e legjislacionit ngarkojnë kundrejt KQZ-së një barrë të madhe për të cilën koha e mbetur në dispozicion është relativisht e shkurtër. Sa më sipër, do të ishte me vend dhe në shërbim të të gjitha palëve, që më së paku, në një situatë të tillë data e depozitimit të listave të kandidatëve pranë KQZ të ishte më e largët nga data e zgjedhjeve, duke i mundësuar kështu KQZ-së kohën e mjaftueshme për kryerjen e verifikimeve përkatëse. Ndërkaq, në çdo rast koordinimi ndërmjet institucioneve mbetet një komponent kyç për realizimin me sukses të këtij misioni.**

¹ Për zgjedhjet e vitit 2019, KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme organizuan disa takime për koordinimin dhe bashkëpunimin në funksion të zbatimit të ligjit.

² Përpunimi i të dhënave për një numër relativisht të madh të formularëve të dekriminalizmit, mund të bëhet vetëm me programe elektronike të përshtatshme për specifikën e të dhënave.



3. VOTA E EMIGRANTËVE/VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

Vota e shtetasve jashtë apo emigrantëve është një fenomen tjetër i cili ka marrë shumë vëmendje në media dhe në trajtimet publike që i janë bërë procesit të diskutimit të legjislacionit zgjedhor. Por, pavarësisht jehonës mediatike dhe politike, si dhe kërkesave të vazhdueshme nga komuniteti shqiptar që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ende nuk është realizuar apo mundësuar e drejta e tyre për të ushtruar të drejtën e votës.

Neni 45/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon shprehimisht, se *çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet*. Natyrisht që mangësia në legjislacionin zgjedhor për mundësimin e realizimit të kësaj të drejte përbën shkelje të të drejtave të njeriut referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e më konkretisht të drejtës së votës.

Një situatë e tillë ka shkaktuar reagimin e Këshillit Koordinues të Diasporës i cili ka ftuar në takim kreun e KQZ-së, Z. Ilirjan Celibashi dhe institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim zhblokimin e ngërçit të konstatuar lidhur me votën e shqiptarëve jashtë vendit.

Vlen të theksohet se Këshilli Koordinues i Diasporës, bashkë me grupe të tjera interesi në Diasporë, ka marrë pjesë aktive në procesin e realizimit të votës së Diasporës për zgjedhjet e 25 prillit 2021. Ndërkaq, nga ana tjetër, Kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, ka theksuar vazhdimisht se afati është i shkurtër që vota e emigrantëve të jetë në masë në këto zgjedhje, megjithatë ai ka shtuar se do të tentohet të ketë pjesëmarrje të tyre sado e vogël qoftë ajo. Ndër të tjera, Z. Celibashi ka theksuar se për të mundësuar votën e emigrantëve duhet konsensusi i të gjitha palëve politike, duke shprehur njëkohësisht dyshimin e tij për realizimin e këtij projekti për shkak të kohës së shkurtër që KQZ ka patur në dispozicion për të përgatitur të gjitha aktet që ajo duhet të kishte. Sipas kreut të KQZ, Kodi Zgjedhor ka një klauzolë në Kodin Zgjedhor, që thotë se KQZ merr një vendim ku do i përfshijë për herë të parë votuesit jashtë Shqipërisë në zgjedhje. Z. Celibashi shprehet se rregullatori është në të drejtën e vet ta marrë këtë vendim, por sipas tij nuk është e thënë që në këto zgjedhje duhet zgjidhur kjo gjë.

Në fakt, dispozita së cilës i referohet Z. Celibashi, është neni 24/3 i Kodit Zgjedhor, i cili shprehimisht parashikon, se *KQZ-ja duhet të marrë vendim për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit*. Ndërkaq, neni 24/2 i Kodit Zgjedhor specifikon, se *votimi nga jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji*.



Për sa më sipër, rezulton se Kodi Zgjedhor, përmes nenit 24/3, në pamje të parë duket sikur i ka lënë shumë hapësira KQZ për të patur diskrecion lidhur me kohën se kur do duhej të aplikohet për herë të parë votimi nga jashtë vendit. Por, në fakt, nëse do i bëhej një interpretim teleologjik kësaj dispozite, si dhe duke marrë në konsideratë kontekstin socio-politik kur u miratuan ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, rezulton se kjo dispozitë është obligatore dhe qëllimi i saj është aplikimi i votimit nga jashtë vendit që në zgjedhjet e datës 25.04.2021. Por, pavarësisht sa më sipër, rezulton se përtej diskutimeve politike dhe vëmendjes gjatë këtij procesi zgjedhor, sërish tema e votimit të emigrantëve rrezikon të mbetet në letër. Kjo pasi jo vetëm që partitë politike nuk arrijnë të gjejnë konsensusin për këtë çështje, por nga ana tjetër edhe vetë KQZ nuk ka arritur deri tani të përcaktojë modalitetin e votimit të emigrantëve, duke mos hartuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit.

4. DEKRIMINALIZIMI

Një tjetër çështje shumë e rëndësishme lidhur me procesin zgjedhor në Shqipëri vijon të mbetet ende dekriminalizimi. Kodi Zgjedhor i ndryshuar përcakton se jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve subjektet zgjedhore regjistrojnë në KQZ, listat shumëemërore të kandidatëve për deputet/organet e qeverisjes vendore. Afati për regjistrimin e listave të kandidatëve në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, përfundoi më datë 6 mars³ 2021. Pranë KQZ-së janë regjistruar si subjekte zgjedhore 46 parti politike dhe 8 Komitete Nismëtarë. Në datën 8 mars 2021 janë regjistruar edhe listat shumëemërore të kandidatëve për deputet ose kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Referuar Ligjit Nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me qëllim që të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose nga funksioni publik i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, duhet të verifikojë të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për mijëra kandidatë.

Afatet, sipas Kodit Zgjedhor⁴, për regjistrimin e listave shumëemërore të kandidatëve janë të ngushta dhe KQZ përveç verifikimit të plotësisht të kriterëve sipas Kodit Zgjedhor, duhet të kryejë verifikimin e të dhënave në formularët e vetëdeklarimit në përputhje me procedurat e parashikuara nga Ligji 138/2015. Garantimi i suksesit për verifikimin e të dhënave në formularët e vetëdeklarimit përfshin kontributin dhe bashkëpunimin edhe të institucioneve të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe nga ana tjetër nevojitet marrja e masave me burime njerëzore për infrastrukturën e përshtatshme për përpunimin.

³ Duke qenë se data 6 mars është ditë e shtunë, referuar nenit 125 të KZ, afati i regjistrimit të listave shumëemërore shtyhet ditën e hënë datë 8 mars 2021.

⁴ Sipas nenit 73 të KZ afati për verifikimin e kandidatëve është 10 ditë.



Ndryshimet ne Kodin Zgjedhor me ligjin Nr. 101/2020, datë 23.7.2020 përcaktuan se, zgjedhësi në zgjedhjet e datës 25 prill 2021, voton për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor. Kandidatët rirenditen në bazë të votimit parapëlqyes. Rrjedhimisht, integriteti i figurës së kandidatit ndikon drejtpërdrejtë në rezultatin e zgjedhësve.

KQZ për të parandaluar, kandidimin e individëve me rekorde kriminale, të cilët më pas mund të jenë deputetë të ardhshëm në Kuvendin e Shqipërisë, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar transparencën dhe verifikimin e të dhënave të Formularëve të Vetëdeklarimit për një numër relativisht të lartë të kandidatëve dhe për më tepër për një periudhë të shkurtër.

5. COVID-19 DHE E DREJTA E VOTËS

Pandemia COVID-19 ka shfaqur gjithashtu një sërë sfidash në drejtim të implementimit të legjislacionit zgjedhor. Kjo pasi shumë shtetas në Republikën e Shqipërisë rezultojnë të infektuar me këtë sëmundje dhe aktualisht gjenden në kushte karantine. Protokollat anti COVID-19 në fuqi, parashikojnë detyrimin e të gjithë personave që rezultojnë pozitivë me COVID-19 ose shfaqin simptomat e kësaj sëmundjeje që të vetë-karantinohen për një periudhë 14-ditore.

Për sa më sipër, referuar deklaratimeve të Kryeministrit,⁵ rezulton se për personat e vetë-karantinar do të bëhet e njëjta gjë që kanë bërë vendet e tjera. Pra, për ata të cilët janë testuar pozitivë dhe nuk janë negativizuar, do duhet të qëndrojnë në shtëpi. Megjithatë, përpos këtyre deklaratave, ende deri në këto momente nuk ka asnjë masë konkrete lidhur me mënyrën se si do të kryhet votimi nga personat e vetë-karantinar. Natyrisht që në këtë pikë është e rëndësishme të përcaktohen modalitetet e votimit të kësaj kategorie personash në mënyrë që të garantohet e drejta kushtetuese e votës edhe për ta.

6. DOKUMENTACIONI PËR VOTUESIT

Referuar nenit 105 të Kodit Zgjedhor, zgjedhësit mund të votojnë vetëm duke paraqitur një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike, letërnjoftim ose pasaportë. Vlefshmëria e dokumentit të identifikimit është kusht për lejimin e zgjedhësve për të votuar. Në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2019, me ligjin nr. 11/2019, datë 05.03.2019 "Për një shtesë në Ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë" të ndryshuar", për shkak të zgjedhjeve lokale u vendos shtyrja e vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit. Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike të shtetasve shqiptarë,

⁵ Shih raportime si: <https://www.balkanweb.com/votimi-per-te-prekurit-me-covid-rama-nuk-behet-fjalë-ata-që-janë-pozitivë-do-qëndrojnë-në-shtëpi/>



të cilat janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundonte brenda vitit 2019, u zgjat deri në datën 31.12.2019."

Ky është një problem i cili do të konstatohet në çdo proces zgjedhor, që zhvillohet pas vitit 2019. Ligjvënësi përpara zgjedhjeve të vitit 2019, miratoi zgjatjen e vlefshmërisë së dokumentit të identifikimit vetëm për vitin 2019. Ligji nr.11/2019, kishte fuqi juridike vetëm për zgjedhjet e vitit 2019.

Zgjidhje për problematikën e vlefshmërisë së dokumentit të identifikimit në vitin zgjedhor, mund të jetë një ndryshim ligjor, i cili të përcaktojë se vlefshmëria e dokumentit të identifikimit, i cili përfundon në vit zgjedhor, të zgjatet deri më datën 31 dhjetor të këtij viti. Ka debat, por ende nuk ka vendimmarrje në këtë pikë.

7. PROBLEMATIKA ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME KQZ

Ligji Nr. 10019, datë 28.12.2008 "*Kodi Zgjedhor*" (këtu e në vijim referuar si "*Kodi Zgjedhor*"), i ndryshuar së fundmi me ligjin Nr. 101/2020, datë 23.7.2020, ka sjellë disa risi në këtë periudhë zgjedhore si pasojë e ndryshimeve të fundit të tij, por këto ndryshime nuk kanë kaluar pa disa vështirësi në aplikimin e ligjit.

Një problematikë e vëzhguar gjatë kësaj periudhe, sa i përket zbatimit të Kodit Zgjedhor, lidhet kryesisht me caktimin e monitoruesve për financat dhe fushatën elektorale të subjekteve politike. Në këtë pikë sjellim në vëmendje parashikimin e nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, i cili specifikon qartazi se KQZ duhet të emërojë monitorues të tij për fushatën zgjedhore elektorale. Më konkretisht, referuar kësaj dispozite, KQZ-ja duhet që *jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve*, të caktojë një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me detyrimet sipas Kodit Zgjedhor.

Për zbatimin e sa më sipër, KQZ-ja duhet të përcaktonte me një udhëzim të posaçëm kriteret për përzgjedhjen e monitoruesve, si dhe për objektin e monitorimit. Lidhur me këtë detyrim ligjor, është miratuar Udhëzimi Nr. 1, datë 02.02.2021 "*Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit*", i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përmes së cilit janë përcaktuar rregullat për përzgjedhjen e monitoruesve dhe objektin e monitorimit. Në këtë pikë vihet re, se ky udhëzim, i cili mundëson aplikimin e nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, është miratuar nga KQZ vetëm 2 (dy) muaj para datës së zgjedhjeve, kur do duhej të ishte miratuar më herët se 6 (gjashtë) muaj nga dita e zgjedhjeve për të mundësuar zbatimin e duhur të kësaj dispozite.

Për më tepër, në pikën 3 të udhëzimit të sipërcituar, specifikohet se periudha e monitorimit është 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e zgjedhjeve. Pra, sërish, përpos faktit se ky udhëzim e bën akoma edhe më të vështirë zbatimin e ligjit në praktikë, nga ana tjetër, rezulton se edhe parashikimi i këtij ligji nuk është në përputhje me kohën fizike në dispozicion të KQZ. Kjo pasi, brenda vetëm 2 (dy) muajve e gjysmë nga data e



miratimit të këtij udhëzimi do të zhvillohen zgjedhjet. *Pra, aplikimi i këtij udhëzimi është praktikisht i pamundur.*

Sikurse e theksuam edhe më sipër, ligji parashikon shprehimisht se jo më vonë se 6 (gjashhtë) muaj para datës së zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do duhej të kishte emëruar një numër të mjaftueshëm monitoruesish për monitorimin e vlerësimin për shkallën e përputhshmërisë së veprimtarisë së partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre me kushtet dhe kërkesat e pjesës VII, Kreut I, të Kodit Zgjedhor, respektimin e përcaktimeve të bëra në vendimin Nr. 9, datë 24.12.2020 "*Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*" dhe në aktet e tjera nënligjore të nxjerrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nga ana tjetër, vlen të theksohet se pas emërimit dhe para fillimit të periudhës së monitorimit, sipas këtij neni, monitoruesit do duhej t'i ishin nënshtruar trajnimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar dispozitave ligjore dhe akteve të miratuara nga KQZ, rezulton se monitorimi i fushatës do duhej të kishte filluar *më së paku* në datë 25 Dhjetor 2020. Pra, edhe afati ligjor i emërimeve të këtyre monitoruesve do duhej të ishte data 25.12.2020, por pas më shumë se dy muajsh ende nuk është përmbushur plotësisht detyrimi ligjor i KQZ në këtë drejtim.

Monitorimi i fushatës zgjedhore, sipas nenit 92/4 të pjesës VII, Kreu I, të Kodit Zgjedhor, është një procedurë që zbatohet për herë të parë. Në këto kushte, trajnimi i monitoruesve të emëruar është jo vetëm një detyrim ligjor, por njëkohësisht me të drejtë mund të konsiderohet edhe si çelësi për zbatimin me sukses të dispozitave të Kodit Zgjedhor për monitorimin e shpenzimeve të fushatës.

Për më tepër, vlen të theksohet se partitë politike kanë filluar fushatën zgjedhore jashtë periudhës së përcaktuar nga neni 77⁶ i Kodit Zgjedhor, e për rrjedhojë, monitorimi nga KQZ i sjelljes së subjekteve zgjedhore, si dhe ndëshkimi i shkelësve ka një rëndësi të madhe për integritetin, transparencën dhe barazinë e palëve në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021.

Nisur nga sa më sipër duke qenë se kanë ngelur më pak se dy muaj nga data e zgjedhjeve, emërimi dhe trajnimi sa më shpejtë i monitoruesve do të mundësonte të paktën për këtë periudhë, deri në datën e zgjedhjeve, garantimin e standardeve në lidhje me respektimin e rregullave për financimin e fushatës zgjedhore dhe ndalimin e përdorimit të burimeve publike në zgjedhje, si dhe mundësinë për ndëshkimin e parregullsisve. Ndërkaq, një tjetër problematikë lidhur më zbatimin e legjislacionit zgjedhor është edhe veprimtaria e KQZ-së për *raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, si dhe monitorimin e veprimtarisë dhe sjelljes së administratës shtetërore para zgjedhjeve.*

⁶ Neni 77/1 i Kodit Zgjedhor: "*Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*".



Për sa më sipër, Komisioni Rregullator pranë KQZ-së ka miratuar Vendimin Nr.9, të datës 24.12.2020 mbi *"Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"*.

Por, pavarësisht sa më sipër, eksperiencia e dy muajve të parë të funksionimit të rregullave të këtij vendimi, si dhe vendimmarrja e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve (KAS), ka dëshmuar se është i domosdoshëm rishikimi i parashikimeve të Vendimit 9/2020. Për më tepër, rrethanat dhe sjellja e palëve subjekt i kufizimeve të parashikuara kanë krijuar nevojën që këto parashikime të ndryshohen dhe përmirësohen për të garantuar frymën e Kodit Zgjedhor.

Më konkretisht, neni 3, pika 1.1 e Vendimit Nr. 9/2020 parashikon, se *"veprimtari të ndaluara për t'u promovuar" janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:..."*. Togfjalëshi i kësaj dispozite: *"për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve..."*, qartazi lë vend për keqinterpretime.

Komisioni Rregullator në përcaktimin e këtij neni, synon të pengojë instrumentet ekzekutive në përdorimin e fondeve publike në dobi të fushatës elektorale, kjo edhe në frymën e kufizimeve të dakordësuara në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Por, përkufizimi: *"...janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar..."*, përveçse bie ndesh me frymën e vetë Kodit Zgjedhor, nga ana tjetër krijon bindjen se në tërësi pika 1.1. e nenit 3 të Vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator do të jetë jo efektive.

Në këtë pikë, vlen të theksohet se zgjedhjet e 25 Prillit 2021 janë shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 11700 datë 06.09.2020 ndërsa ligji Nr. 137/2020 *"Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2021"* është miratuar më datë 16.11.2020, efektet e të cilit kanë filluar më datë 01.01.2021. Periudha e nisjes së efektit të buxhetit të vitit 2021, i cili përcakton destinacionin e fondeve publike përkon gjithashtu me nisjen e periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve që diktohet në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor.

Buxheti (plani buxhetor i miratuar) është një akt i cili pason dekretin për shpalljen e datës së zgjedhjeve dhe të dyja si ngjarje, si njëra ashtu edhe tjera, janë të parashikueshme që do të ndodhin dhe se kur do të ndodhin. Në këto kushte, nëse qëllimi ka qenë të mos promovohen veprimtari publike të cilat do të ndikojnë në elektorat dhe do të përdoren për qëllime propagandistike, atëherë Komisioni Rregullator nuk duhet të anashkalonte faktin që të tilla veprimtari të ndaluara për promovim mund të jenë të parashikuara në planin buxhetor të miratuar.



Vihet re se kufizimi i parashikuar në pikën 1.1 të nenit 3 të Vendimit 9/2020 vlen vetëm për veprimtaritë publike të ndaluara për t'u promovuar, që nuk janë në planin buxhetor, ndërsa ato të parashikuara në planin buxhetor të miratuar i lejon. Por, kjo nuk i jep zgjidhje çështjes nëse pikërisht problemi ka qenë promovimi i një sërë veprimtarish publike për qëllime propagandistike.

Në vijim të sa më sipër është e vështirë të gjesh ndryshimin midis projekteve infrastrukturore, koncesioneve dhe PPP-ve të miratuara në vjeshtën e vitit 2020 dhe atyre të miratuara dhe vëna në lëvizje nëpërmjet fondeve të transferuara apo të miratuara rishtazi në periudhën Janar-Prill 2021.

Përpos sa më sipër, vlen të sillet gjithashtu në vëmendje, se nga zbatimi në praktikë i legjislacionit zgjedhor është konstatuar edhe një mangësi apo inkoherencë në identifikimin dhe përcaktimin se çfarë përbën termi "media". Në nenin 2 të Vendimit 9/2020 bëhet një përkufizim i qartë se çfarë është veprimtari publike: "... janë ato që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikun, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër-mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre". Legjislatori, po ashtu, në nenin 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor i referohet termit "... media..." kur do të përcaktojë se çfarë përbën veprimtari publike.

Duket qartë që nuk është e specifikuar dhe aq më pak të jetë e përkufizuar në përcaktim nëse media do të konsiderohet ajo e shkruara, vizive, audio, apo sociale si në Kodin Zgjedhor dhe në vendimin e Komisionit Rregullator.

Në kushtet kur dy vendimet e fundit të KAS kanë sjellë një interpretim të ndryshëm mbi atë se çfarë përbën media, vihet re se mos-përcaktimi i saktë i këtij termi shkakton qartazi standarde të ndryshme në zbatimin e legjislacionit zgjedhor. Në këtë pikë, çmojmë se do të ishte me vend që të bëhej edhe përkufizimi se çfarë është dhe përbën "media" duke përfshirë edhe ato sociale, si media më e përhapur, më e efektshme dhe më e fuqishme. Ndërkaq, në dritën e vendimmarrjes së fundit të KAS vihet re, se është e nevojshme që të ketë edhe një qartësim të përgjegjësive administrative për zyrtarët subjekt i kufizimeve të veprimtarive të ndaluara.

Më konkretisht, në nenin 3, pika 2 të Vendimit Nr.9, përcaktohet ndalimi i zyrtarëve të lartë për të drejtuar, marrë pjesë apo kontribuar në çfarëdolloj forme në veprimtari të ndaluara. Neni 4, pika 4, përcakton se: "*Raportimi në ndërfaqe, në emër dhe për llogari të subjekteve të përcaktuara në Nenin 3, pika 2, bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore...*". Nga ana tjetër, neni 10, pika 1, përcakton se: "*Në rastet kur subjektet e parashikuara në nenin 4 pika 4, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga KQZ me gjobë nga 3.000 – 90.000 lekë....*".

Argumentimi i shumicës në Vendimin Nr.6 të KAS ka vënë theksin tek fakti, se Kodi Zgjedhor dhe Vendimi Nr.9 i Komisionit Rregullator, nuk ka përcaktuar përgjegjësi për



zyrtarin (në rastin konkret kryetari i Bashkisë Tiranë) përveç rastit kur ai ka penguar raportimin ose kur ka lejuar zhvillimin e ndonjëres prej veprimtarive të ndaluara nga KQZ.

8. KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE (KAS) DHE VEPRIMTARIA E TIJ

Sikurse e cekëm edhe më sipër, një rol të rëndësishëm në implementimin e legjislacionit zgjedhor këtë periudhë ka luajtur edhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS). Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor është krijuar për herë të parë ky komision, i përbërë nga 5 anëtarë⁷ dhe që është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative, si edhe për vendosjen e sanksioneve për shkeljet e ligjit zgjedhor. KAS ka për detyrë të shqyrtojë dhe të zgjidhë në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit dhe KZAZ-ve. Me kërkesë të Komisionerit, KAS vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë apo sanksione administrative kundër personave/subjekteve zgjedhore që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

KAS është parashikuar të jetë i pavarur dhe përmes vendimmarrjeve të tij të krijojë standarde ligjore dhe administrative për zgjedhjet. Megjithatë, monitorimi i deritanishëm tregon se KAS reflekton pavarësi të brishtë dhe ende nuk ka krijuar norma referuese në vendimmarrje. Norma të tilla do të duhej të kishin votat e 5 anëtarëve dhe të mos kishte kontestime mbi cilësinë apo përmbajtjen e vendimmarrjeve. Gjithashtu, duhet theksuar se anëtarët e KAS gjatë viteve të fundit kanë patur angazhim politik pranë partive kryesore politike⁸. Të përzgjedhur nga palët politike me raportet 3 vs 2, vihet re se anëtarët e KAS kanë krijuar që në fillim të aktivitetit të KAS një opinion negativ mbi paanësinë politike në vendimmarrjen e këtij institucioni. Kjo gjë është vënë re edhe në dy vendimet e marra deri tani nga ky komision, ku anëtarët janë pozicionuar politikisht, sipas pozicioneve të subjekteve politike që i kanë mbështetur, duke u ndarë në vendimmarrje në raport 3 me 2.

Lidhur me aktivitetin e KAS, vlen të theksohet se deri tani⁹ ky i fundit ka shqyrtuar 3 kërkesa ankimore dhe ka miratuar me shumicë votash 2 vendime përfundimtare (*3 pro dhe 2 kundër*) dhe 2 vendime të ndërmjetme. Konkretisht janë paraqitur fillimisht kërkesat ankimore Nr. 1 të Z. Arben Qalliu dhe Nr. 2 të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim me objekt të përbashkët: "*Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Arben Qalliu"*, të paraqitura në KQZ në datën 18.01.2021. Ankimi nga Z. Arben Qalliu, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Vendore Lushnjë në Agjencinë Shtetërore

⁷ Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë Nr.59/2020.

⁸ Z. Ilir Rusmali, ish funksionar i lartë politik dhe ish-Ministër i Drejtësisë i Partisë Demokratike, Z. Koli Bele, ish-funksionar i lartë administrativ dhe politik në mandatin e qeverisë aktuale dhe përfaqësues politik i Partisë Socialiste në Këshillin Bashkiak Tiranë, Z. Elvin Lako funksionar i lartë administrativ në disa institucione të qeverisë aktuale dhe i angazhuar politikisht pranë Partisë Socialiste në disa fushata elektorale në Tiranë, Z. Elvis Çefa, ish-funksionar i lartë administrativ i zgjedhur dhe mbështetur politikisht nga Partia Demokratike për emërimin e tij si Zv. Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Z. Ledio Braho funksionar pranë Presidentit të Republikës, avokat i disa proceseve në mbrojtje të figurave dhe veprimtarëve të Partisë Demokratike.

⁹ Vendim i KAS, datë 25.02.2021.



të Kadastrës dhe tjetri i depozituar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në cilësinë e denoncuesit, janë bashkuar si kërkesa ankimore me vendim të KAS.

Objekti i këtyre ankesave ka qenë i lidhur me faktin, se Z. Qalliu në kundërshtim me legjislacionin në fuqi ka lejuar që të shpërndahen leje legalizimi, duke cënuar rregullat mbi përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë. Për këtë veprimtari, me vendimin Nr. 7, datë 14.01.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të gjobisë Z. Qalliu me 1500 lekë. Ndërkaq, me Vendimin Nr. 4, datë 22.01.2021, KAS me shumicë votash ka vendosur të anulojë gjobën ndaj Z. Qalliu me argumentimin se ai ka qenë duke kryer detyrën e tij shtetërore dhe nuk ka shkelur asnjë rregull të ndalimit të veprimtarisë shtetërore gjatë periudhës 4 mujore para zgjedhjeve. Në mendimin e pakicës së KAS të firmosur nga anëtarët Z. Braho dhe Z. Çefa është argumentuar midis të tjerash, se veprimtaria e Z. Qalliu ka qenë flagrante në kundërshtim me ligjin dhe ai duhej gjobitur.

Nga një analizë e shpejtë e të dhënave të administruara mbi rastin e mësipërm, konstatohet se shumica e anëtarëve të KAS nuk kanë arritur të argumentojnë lehtësimin e pozitës juridike si kundërvajtës të Z. Qalliu, por është munduar të interpretojë teknikalitete mbi kushtet, rrethanat dhe dokumentet apo shërbimet që mund të konsiderohen ndalime zgjedhore sipas Nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, krijohet ideja se KAS ka marrë pa të drejtë kompetencat e Komisionit Rregullator, duke përkufizuar norma dhe rregulla mbi konsiderimin e rasteve të shkeljeve gjatë periudhës zgjedhore, detyrë të cilën e normon nëpërmjet vendimeve përkatëse *Komisioni Rregullator*.

KAS ka marrë në shqyrtim gjithashtu edhe kërkesën ankimore të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës Z. Erjon Veliqaj, i cili ka kundërshtuar Vendimin Nr. 46 datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet që e ka gjobitur atë në shumën 35 000 (*tridhjetë e pesë mijë*) lekë për shkelje të nenit 92 të Kodit Zgjedhor për mosraportim të aktiviteteve publike, si dhe në shumën 40 000 (*dyzetë mijë*) lekë për shkelje për kryerjen e aktiviteteve të ndaluara gjatë fushatës elektorale. Aktualisht është njoftuar zyrtarisht shfuqizimi i gjobave në ngarkim të Z. Veliqaj me anë të një vendimi me shumicë votash të KAS, i cili nuk është zbardhur dhe nuk është bërë ende publik. Sipas të dhënave paraprake të publikuara online nga faqja e KQZ/KAS, edhe në këtë rast KAS është ndarë në votimin e këtij vendimi në raportin 3 me 2, ku në pakicë figurojnë anëtarët Z. Braho dhe Z. Çefa.

Në rastin e marrjes në shqyrtim të kësaj çështje, ku relator është caktuar ish anëtari i Këshillit Bashkiak Tiranë Z. Koli Bele, vihet re se ka një moment, i cili duhet parë nën dritën e papajtueshmërisë së gjendjes së konfliktit të interesit, gjë e cila duhet të ishte korrigjuar që në momentin e parë të depozitimit të kësaj kërkesë.

Neni 16/7 i Kodit Zgjedhor qartazi parashikon se *anëtarët e KAS-it u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave*. Neni 3/1 i ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 "*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve*", i ndryshuar, parashikon, që "*Konflikt i interesit*" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në



kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Ndërkaq, neni 3/2 i Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, specifikon se "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësi" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

Nga sa më sipër, jo më kot legjislatori ka parashikuar togfjalëshin "për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.". Kjo pasi, pavarësisht se në të vërtetë zyrtari mund të mos ketë konflikt faktik interesi, do të mjaftonte cënimi i besueshmërisë së institucionit ku ai punon, apo figurës së tij për të konsideruar veprimtarinë e tij si në konflikt interesi. Rrjedhimisht, të tilla veprime nga ana e KAS, siç është rasti i relatorit Z. Koli Bele, krijojnë dyshimin e arsyeshëm në publik lidhur me paanësinë e këtij organi, e për këtë shkak të tilla situata do duhet të konstatoheshin që në momentin që fillon procedurat KAS.

Në vijim të sa më sipër, në kuadër të monitorimit të veprimtarisë administrative, të ngritjes dhe vënies në funksionim të KAS, konstatohet se këtij organi i është miratuar me Vendimin Nr. 03 datë 06.11.2021 nga Komisioni Rregullator, "Rregullorja e Mënyrës së Funksionimit të Zhvillimit të Seancave të KAS". Ky dokument është një akt me natyrë tërësisht procedurale dhe mbulon vetëm veprimtarinë vendimmarrëse të KAS. Ndërkohë, që për aspekte të tjera të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të KAS, të së drejtës së informimit dhe kodit etik nuk figurojnë të jetë miratuar ende aktet përkatëse. Nga ana tjetër, vihet re gjithashtu se ka edhe vonesa të ndjeshme në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të KAS dhe të dokumentacionit të plotë të palëve (*denoncimi, komunikimet dhe vendimet zyrtare, etj.*).

Shqetësim është edhe fakti se rastet e deritanishme kanë qenë demotivuese për denoncime e raportime nga individë dhe shoqëria civile për shkelje të Kodit Zgjedhor, pasi është krijuar perceptimi se në KQZ ka dy linja vlerësi për të njëjtat argumente ligjore, nga Komisioneri Shtetëror dhe nga KAS dhe se, vendimet e deritanishme tregojnë se nuk janë të qarta konceptet e shkeljes ligjore që nënkuptojnë dispozita të veçanta të Kodit Zgjedhor.



